



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 661 prot.

Tiranë, më 18.12.2019

URDHËR

NR. 172 DATË 18/12/2019

PËR

MIRATIMIN E KODIT TË BRENDSHËM ETIK TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)

Në zbatim të ligjit Nr. 10 303, datë 15/07/2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", të Statutit dhe Rregullores së Brendshme të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Kodit të Brendshëm Etik të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen të gjithë punonjësit e AIDA-s për zbatimin e saj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

KODI I BRENDSHËM ETIK
I AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

HYRJE

AIDA, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe nënligjore dhe me vizion të qartë drejt së ardhmes, prezanton misionin si një institucion në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit përmes lehtësimit dhe mbështetjes së investimeve të drejtpërdrejta në Shqipëri, rritjes dhe konkurrencës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe promovimit dhe ofrimit të ndihmës për eksportet e mallrave dhe shërbimeve.

Për arritjen e këtij misioni, AIDA duhet të perceptohet si një institucion objektiv dhe profesional, në të cilin duhet të kenë besim të plotë të gjithë institucionet dhe palët e interesuara që janë subjekte bashkëpunuese me AIDA-n, por edhe publiku në tërësi.

Bazuar në ligjin nr. 10 303, datë 15/07/2010, "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", si dhe tërësinë e akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, punonjësit e AIDA-s duhet të ushtrojnë detyrat dhe funksionet e tyre në mënyrë profesionale dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin specifik, legjisllacionin mbi kodin e punës, statutin dhe rregulloren e brendshme të institucionit, si dhe Kodin e Brendshëm të Etikës.

Referuar gjithë sa më sipër, si dhe faktit që zbatimi i rregullave të sjelljes dhe etikës është komponent kyç dhe parakusht për krijimin e besimit tek AIDA, hartohet Kodi i Brendshëm Etik i AIDA-s (që këtu e më poshtë KBE), sipas tekstit vijues.

Neni 1

1. KBE është deklarata gjithëpërfshirëse e vlerave, sjelljeve dhe parimeve, të cilat duhet ndiqen dhe të udhëheqin të gjithë veprimtarinë e punonjësve të AIDA-s.
2. KBE përcakton standardet etike si dhe ofron udhëzime e kërkesa të nevojshme për t'u zbatuar nga punonjësit e AIDA-s me synim që, gjatë veprimtarisë së tyre, të reflektojnë një nivel të lartë etik si dhe të respektojnë parimet dhe vlerat themelore të funksionimit të tij.

Neni 2

1. Të gjithë punonjësit e AIDA-s janë përgjegjës për reputacionin e institucionit dhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duhet të udhëhiqen sipas shembullit të mirë e të jenë model të integritetit.
2. Ata duhet të jenë të vetëdijshtëm se sjelljet e tyre, kanë një ndikim të fortë në mënyrën se si perceptohet institucioni, si ndikojnë në forcimin e autoritetit dhe besueshmërisë institucionale dhe, për pasojë, në perceptimin e aktivitetit të AIDA-s si një vlerë, dobi dhe e mirë e përbashkët për të gjithë vendin.

Neni 3

1. KBE ka për qëllim të pajisë të gjithë punonjësit e AIDA-s me një bashkësi parimesh, vlerash dhe standardesh, në të cilat të bazohet sjellja etike e tyre në funksion të përmbushjes së pritshmërisë së palëve të interesuara, ku kryerja e detyrave dhe përmbushja e detyrimeve duhet të mbizotërojë mbi interesat e çdo punonjësi të AIDA-s.
2. Përgjatë këtij Kodi, termi “punonjësit e AIDA-s” përfshin të gjithë punonjësit e AIDA-s, por edhe punonjësit e përkohshëm apo ekspertet e jashtëm të kontraktuar sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Pavarësisht sa përcaktohet këtu, KBE nuk eliminon apo mënjanon aktet e tjera ligjore e nënligjore, rregulloret apo manualet e ndryshme të zbatueshme, që trajtojnë çështjet e etikës, por është një mjet për të inkurajuar dhe promovuar kulturën etike, diskutimet lidhur me etikën dhe për të përmirësuar qëndrimet apo reagimet në punë.
4. Është detyrim i çdo punonjësi që, gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tij, të zbatojë standardet dhe kërkesat etike në nivelin që kërkohet në këtë kod dhe devijimet nga niveli i kërkuar do të konsiderohen shkelje të këtij kodi. Të gjithë punonjësit e AIDA-s kanë përgjegjësi për të kontribuar në “qeverisjen e mirë” të AIDA-s dhe në mbajtjen lart të emrit të institucionit për ndershmëri, korrektësi, drejtësi, integritet, paanshmëri, përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Neni 4

Punonjësit e AIDA-s duhet ta bazojnë veprimtarinë e tyre në vlerat bazë etike, që janë:

- a) integriteti;
- b) pavarësia, objektiviteti dhe paanshmëria;
- c) ruajtja e sekretit profesional;
- ç) kompetencat dhe kujdesi i duhur;
- d) sjellja profesionale.

Neni 5

1. Integriteti është vlera kryesore e KBE, në të cilën bazohet e gjithë veprimtaria institucionale e AIDA-s.
2. Në lidhje me integritetin institucional:
 - a) AIDA aplikon standarde të larta të integritetit dhe etikës për stafin në të gjitha nivelet;

- b) AIDA udhëheq sipas shembullit të mirë;
- c) AIDA siguron një sistem efektiv të sistemit të kontrollit të integritetit në institucion, duke përfshirë një set masash e kontrollesh të mirë balancuara;
- ç) AIDA siguron një sistem të vazhdueshëm informimi për rëndësinë e integritetit dhe sigurohet që niveli drejtues udhëheq sipas shembullit të mirë;
- d) AIDA merr masa dhe vendos sisteme kontrolli të brendshme që të eliminojë tundimet, të cilat mund të stimulojnë punonjësit të veprojnë në mënyrë të papërshtatshme;
- dh) AIDA nuk toleron shkeljet e integritetit dhe është e përgatitur se, pavarësisht masave shtrënguese, shkeljet e integritetit mund të ndodhin.

3. Në lidhje me integritetin individual:

- a) integriteti i punonjësve të AIDA-s është një përgjegjësi personale, një detyrim pa kompromis për zbatimin e kërkesave ligjore, rregulloreve, vlerave morale dhe etike;
- b) integriteti shërben si një orientim për të gjithë punonjësit dhe i ndihmon ata për të gjetur rrugën e tyre edhe kur rregullat mungojnë;
- c) punonjësit e AIDA-s duhet të bëjnë kujdes dhe të ushtrojnë përgjegjësitë dhe kompetencat, në funksion të interesit të përbashkët dhe publikut;
- ç) për të ruajtur besimin e subjekteve bashkëpunues dhe publikut, sjellja e punonjësve të AIDA-s duhet të jetë mbi çdo dyshim dhe qortim publik; ata duhet të kenë një ndershmëri absolute në kryerjen e punës së tyre dhe në trajtimin e burimeve të AIDA-s.

4. Integriteti në ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen profesionale të detyrave përbën bazën për besueshmërinë e rezultateve të punonjësve të AIDA-s për palët e interesit, Bordin Drejtues, qeverinë dhe publikun.

5. Integriteti mund të matet sipas asaj që është e ligjshme dhe e drejtë. Integriteti u kërkon punonjësve të vëzhgojnë standardet etike, si dhe të respektojnë parimet e pavarësisë dhe objektivitetit, të ruajnë standardet e sjelljes profesionale, të marrin vendime duke pasur në mendje interesin publik. Punonjësit e AIDA-s duhet të punojnë në mënyrë të besueshme, të ndershme dhe të përgjegjshme gjatë gjithë kohës që janë në detyrë, duke u përpjekur për të arritur rezultatet më të mira të mundshme.

6. Rëndësi të veçantë ka:

- a) kryerja e kujdesshme dhe në kohë e detyrave dhe udhëzimeve të eprorëve;
- b) profesionalizmi dhe matura në kryerjen e detyrave;
- c) punonjësit e AIDA-s duhet të jenë të vetëdijshëm që të mos i shmangen trajtimit të problemeve dhe zgjidhjeve të vështira, në rast se interesi publik kërkon ndjeshmërinë e duhur dhe, në të njëjtën kohë, veprime të efektshme dhe të mirë përcaktuara;
- ç) punonjësit e AIDA-s duhet të jenë kreativë dhe të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë aktive dhe me kujdesin e duhur profesional;
- d) nëse punonjësit e AIDA-s konsiderojnë se një udhëzim apo urdhër është i paligjshëm apo i gabuar, ata duhet të paraqesin rezervat dhe objeksionet e tyre me shkrim tek eprori i drejtpërdrejtë. Nëse udhëzimi është i ri konfirmuar me shkrim,

punonjësit janë të detyruar ta zbatojnë atë. Nëse më vonë del se rezervat dhe objeksionet e paraqitura nga punonjësi ishin të justifikuara, të drejta dhe të ligjshme, eprori që dha urdhrin apo udhëzimin e gabuar duhet të marrë përgjegjësitë për veprimet e ndërmarra;

dh) punonjësve të AIDA-s nuk u lejohet të zbatojnë një udhëzim apo urdhër, nëse ata janë të bindur se kjo do të çojë në një veprë penale ose dëm të pakthyeshëm.

Neni 6

1. Punonjësit e AIDA-s duhet të sillen në një mënyrë që të nxjerrin në pah vlera të tilla etike siç është pavarësia, paanshmëria, dhe objektiviteti, jo vetëm “në dukje”, por edhe “në fakt”.
2. Pavarësia e punonjësve të AIDA-s nuk duhet të dëmtohet nga interesa personale ose të jashtme, duke pasur si detyrim që t'i shmangen përfshirjes në të gjitha çështjet, ku ata kanë interes vetjak për të zbatuar me përpikëri kërkesat ligjore dhe nënligjore, në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesave apo në ushtrimin e funksioneve publike.
3. Punonjësit e AIDA-s duhet të veprojnë me paanshmëri duke treguar kujdes që shprehja e pikëpamjeve dhe e bindjeve personale të mos komprometojë apo të duket se komprometon rezultatet e detyrave të ngarkuara apo interesat e AIDA-s. Sjellja zyrtare duhet të karakterizohet gjithnjë nga objektiviteti dhe profesionalizmi duke shmangur situatat që krijojnë konflikte interesash.
4. Punonjësit e AIDA-s duhet të ruajnë pavarësinë e tyre nga ndikimi politik dhe të tregojnë neutralitet politik në fakt dhe në dukje, në mënyrë që të përmbushin përgjegjësitë dhe detyrat e tyre në mënyrë të paanshme.
5. Punonjësit e AIDA-s nuk duhet të përfshihen në dukje dhe në fakt, në asnjë lloj mënyre, në menaxhimin dhe krijimin e marrëdhënieve të ngushta me subjektet bashkëpunuese.

Neni 7

1. Punonjësit e AIDA-s duhet të tregohen kompetentë dhe të kenë kujdesin e duhur në kryerjen e detyrave të tyre. Ata duhet të kenë njohuri të mjaftueshme të parimeve kushtetuese, ligjore, institucionale dhe standardeve që rregullojnë veprimtarinë e punës së tyre. Ata duhet të demonstrojnë që zotërojnë aftësitë profesionale, duhet të ruajnë dhe të zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.
2. Punonjësit e AIDA-s nuk duhet të marrin përsipër kryerjen e detyrave për të cilat ata nuk janë kompetentë dhe të aftë profesionalisht për ta realizuar atë me sukses.
3. Punonjësit e AIDA-s duhet të kryejnë detyrat e tyre me devotshmëri, kompetencë dhe, në mënyrë të vazhdueshme, duhet të ruajnë dhe përsosin njohuritë e aftësitë e tyre profesionale, në nivelin dhe standardin e kërkuar, me qëllim që të garantojnë kryerjen e veprimtarisë në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore.
4. Punonjësit e AIDA-s, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të sillen si profesionistë dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale, në funksion të kryerjes me sukses të detyrave të caktuara, me synim arritjen e rezultateve, sipas standardeve institucionale të vendosura.

Neni 8

1. Punonjësit e AIDA-s duhet të ruajnë mirëbesimin e informacionit, që kanë në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8503, date 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".
2. Punonjësit e AIDA-s kanë detyrimin dhe janë përgjegjës për ruajtjen e informacionit të marrë me mirëbesim gjatë kryerjes së detyrave profesionale. Detyrimi për të ruajtur sekretin vazhdon të zbatohet edhe pas largimit nga AIDA.
3. Detyrimi për ruajtjen e mirëbesimit nuk duhet të kufizojë lirinë individuale të shprehjes.
4. Punonjësit e AIDA-s duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur në përdorimin e informacioneve të marra gjatë kryerjes së detyrave profesionale dhe t'i mbrojnë ato nga përdorimi i paautorizuar.
5. Punonjësit e AIDA-s nuk duhet të zbulojnë informacionet e marra gjatë ushtrimit të detyrave nga palëve të treta, qoftë me gojë ose me shkrim, përveçse për të përmbushur përgjegjësitë ligjore të AIDA-s apo përgjegjësi të tjera të identifikuara si pjesë e procedurave normale të AIDA-s ose ato në përputhje me ligjet përkatëse. Ata nuk mund t'i bëjnë publike e t'i përdorin këto informacione përveçse kur u kërkohet sipas dispozitave të parashikuara me ligj.
6. Punonjësit e AIDA-s nuk duhet t'i përdorin informacionet e marra gjatë ushtrimit të detyrave për ndonjë përfitim personal. Ata gjithashtu nuk mund t'i përdorin këto informacione kur përdorimi i tyre është në kundërshtim me ligjin dhe mund të dëmtojë subjektin dhe/ose vetë AIDA-n.
7. Në rast se punonjësi i AIDA-s, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, përballet me dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike dhe çdo informacion tjetër që përbën sekret shtetëror, sipas përcaktimeve të legjislacionit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror, ai duhet të ruajë konfidencialitetin.
8. Punonjësi i AIDA-s është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacioneve të siguruara për shkak të detyrës, të cilat mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 9

1. Punonjësi i AIDA-s duhet të ketë një sjellje profesionale model dhe të veprojë në mënyrë të tillë që të ruajë emrin dhe reputacionin institucionit dhe të profesionit të tij si dhe të distancohet nga çdo lloj sjellje e veprim që mund të diskreditojë figurën e tij.
2. Punonjësi i AIDA-s, duhet të kontribuojë si në përmbushjen e objektivave të AIDA-s ashtu edhe në realizimin e misionit dhe vizionit institucional, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë profesionale në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor, statutin e AIDA-s, rregulloret, manuallet, etj.
3. Punonjësi i AIDA-s, duhet veprojë me ndershmëri dhe korrektesë, si në jetën profesionale ashtu edhe në jetën private.

Neni 10

1. Punonjësit e AIDA-s kanë përgjegjësinë, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të zbatojnë rregullat e sjelljes etike dhe të kontribuojnë në zhvillimin e institucionit për të

qenë një institucion model, efikas dhe që “udhëheq sipas shembullit të mirë”.

2. Të zbatosh rregullat e sjelljes etike do të thotë:

- a) të veprosh me ndershmëri, profesionalizëm, objektivitet, përkushtim dhe paanshmëri në zbatimin e detyrave të ngarkuara;
- b) të shmangësh çdo formë të diskriminimit dhe të kontribuosh për zbatimin e një politike të mundësive të barabarta për të gjithë;
- c) të respektosh standardet bazë të sjelljes dhe komunikimit, si brenda ashtu dhe jashtë mjedisit të AIDA-s;
- ç) të veprosh në përputhje me interesat e AIDA-s, duke nënkuptuar asnjë detyrim për të ndjekur diçka të paligjshme ose jo etike;
- d) të kontribuosh në zbatimin e në politike të hapur komunikimi, të inkurajosh dialogun, diskutimet e hapura dhe pa paragjykim;
- dh) të mos jesh indiferent kur duhet të përballesh me probleme etike;
- e) të eliminosh mungesën e respektit ndaj të tjerëve, padrejtësitë dhe pandershmëritë;
- ë) të nxitësh përgjegjshmërinë;
- f) të jesh krenar për atë që është arritur dhe se si është arritur;
- g) të mos nxjerrësh apo të përdorësh privatisht ndonjë informacion konfidencial, të siguruar nëpërmjet punës në AIDA;
- gj) të shmangësh pjesëmarrjen në aktivitetet e jashtme, të cilat përbëjnë konflikt interesi.

Neni 11

1. Punonjësit e AIDA-s, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duhet të kenë sjellje të mirë administrative, të tregojnë devotshmëri dhe të angazhohen maksimalisht për t'i shërbyer interesave të publikut në funksion të përmbushjes së pritshmërive në drejtim të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe të një administrate sa më të mirë që “udhëheq sipas shembullit të mirë”.
2. Në marrëdhënie me të tretët punonjësit e AIDA-s duhet të tregojnë përkushtim, aftësi, mirësjellje dhe ndihmesë.

Neni 12

1. Me konflikt interesi kuptohet konflikti ndërmjet interesit privat dhe interesit publik gjatë marrëdhënieve juridike të punës në AIDA.
2. Konflikti i interesit është situata në të cilën punonjësi i AIDA-s ka një interes personal të tillë që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës zyrtare. Rastet e konfliktit të interesave janë të përcaktuara në Ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
3. Punonjësit e AIDA-s duhet të veprojnë gjithnjë në interes të institucionit dhe veprimtaria e çdo punonjësi duhet të jetë në përputhje me ligjet, rregullat dhe misionin e AIDA-s.
4. Punonjësit e AIDA-s duhet të jenë të pavarur, objektivë dhe të paanshëm gjatë mbledhjes, vlerësimit dhe përcjelljes së informacionit mbi aktivitetin e të tretëve. Ata nuk duhet të lejojnë që paragjykimet, konflikti i interesit ose persona të tretë të influencojnë në

mënyrën se si ata kryejnë punën dhe detyrat e tyre.

5. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, punonjësit e AIDA-s nuk duhet të lejojnë të gjenden nën presionin dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm. Për të kundërshtuar në mënyrë të efektshme përpjekjet ose influencat, ata nuk duhet të jenë të përfshirë në ndonjë aktivitet që mund të ketë ndikim në pavarësinë dhe objektivitetin e tyre dhe, për pasojë, mbi pavarësinë dhe objektivitetin e AIDA-s. Kjo veçanërisht i referohet:
 - a) interesave financiare si dhe marrëdhënieve të ngushta me personat që kanë interesa të tilla;
 - b) këndvështrimeve ose përfitimeve personale, të cilat influencojnë paanësinë në kryerjen e detyrave;
 - c) marrëdhënieve personale me të tretët, që i tejkalojnë marrëdhëniet profesionale;
 - ç) aktiviteteve politike ose shprehjes së qëndrimeve politike në lidhje me të tretët dhe me aktivitetin e tyre;
 - d) punësimeve të mëparshme të të tretët;
 - dh) të afërmeve ose miqve të punonjësit të AIDA-s, të punësuar të të tretët me të cilët AIDA është në marrëdhënie bashkëpunimi.
6. Çdo punonjësi i AIDA-s duhet të jetë i vetëdijshëm për një konflikt të mundshëm interesi. Për këtë ata janë të detyruar që të plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesave. Mosdeklarimi i konfliktit të interesit ngarkon me përgjegjësi punonjësin.
7. Punonjësit e AIDA-s duhet t'i bëjnë të ditur eprorit të gjitha marrëdhëniet e që krijojnë ose mund të krijojnë konflikt interesi. Në këto raste drejtuesi duhet:
 - a) të mbajë shënim në dosjen e punonjësit dhe të jetë i kujdesshëm për kryerjen e çdo veprimi tjetër, kur konflikti i interesit është minimal ose mund të eliminohet nga një mbikëqyrje e efektshme.
 - b) të kërkojë nga punonjësi që të eliminojë konfliktin e interesit;
 - c) t'i caktojë punonjësit kryerjen e një detyre të ndryshme nga ajo që mund ta vendoste atë në kushtet e konfliktit të interesit, pa i sjellë atij ndryshime në kushtet e punësimit;
 - ç) në rastet kur ekzistenca e një konflikti interesi nuk është e qartë, eprori i punonjësit i drejtohet Drejtorit Ekzekutiv, i cili vetë ose përmes Komisionit të Etikës, bën vlerësim konkret të situatës dhe jep përgjigjen përfundimtare.
8. Verifikimi i situatave të ndryshme, të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesash, kur nuk mund të kryhet dot nga eprori direkt i punonjësit ose Drejtori Ekzekutiv, kryhet nga Komisioni i Etikës, i cili përpilon raportin për kualifikimin e rrethanave përkatëse (nëse përbëjnë ose jo konflikt interesash), mbas informacionit të marrë nga punonjësi dhe eprori i tij direkt.
9. Punonjësit e AIDA-s nuk duhet të përdorin pozitën e tyre zyrtare për qëllime private dhe duhet të shmangin marrëdhëniet dhe kontaktet sociale me subjekte, të cilat mund të influencojnë, komprometojnë dhe/ose venë në rrezik aftësitë e tyre për të kryer detyrat si punonjës i AIDA-s.
10. Pa paragjykuar disiplinën e kërkuar në rregullat e zbatueshme të stafi i AIDA-s, disa nga llojet e interesave që krijojnë konflikte mund të jenë këto të paraqitura në vijim:
 - a) interesa, të cilët klasifikohen sipas përcaktimeve ligjore si me sipër;

- b) interesa të tjera të përcaktuar me akte nënligjore, të dalë në zbatim të ligjit;
- c) interesa tregtare ose jotregtare që punonjësi ka në:
 - (i) subjekt tregtar, fitimprurës ose jofitimprurës, në të cilët punonjësi shërben si konsulent, si ortak, si përfaqësues, agjent, etj.;
 - (ii) subjekt tregtar, me të cilët punonjësi negocion ose ka rënë dakord për një punësim apo angazhim kontraktor ose jokontraktor të ardhshëm të tij.
- ç) çdo lloj interesi tregtar ose jotregtar, i deklaruar nga punonjësi në AIDA.

11. Konfliktet e mundshme të interesit, të një kandidati për t'u punësuar në administratën e AIDA-s duhet të zgjidhen përpara emërimit të tij dhe në rast gabimi të mëparshëm, duhet të korrigjohen me dëshirën dhe vullnetin e mirë të punonjësit dhe AIDA-s.

Neni 13

1. Gjatë punësimit në AIDA, punonjësve nuk u lejoheq që të kërkojnë ose të pranojnë drejtpërsëdrejti ose jo drejtpërsëdrejti, dhurata, shpërblime, favore, argëtime, kredi, hua ose çdo gjë tjetër, që ka vlerë monetare, nga persona ose subjekte që:
 - a) kanë ose që kërkojnë të sigurojnë përfitime në procedurat administrative, në marrëdhëniet kontraktore ose në çdo marrëdhënie tjetër me AIDA-n;
 - b) kryejnë transaksione ose veprimtari, të cilat mbikëqyren/ndiqen nga AIDA;
 - c) kanë interesa që preken në mënyrë thelbësore nga kryerja ose nga moskryerja e detyrave zyrtare të punonjësve të AIDA-s.
2. Punonjësit e AIDA-s duhet të mbrojnë pavarësinë e tyre dhe të shmangin çdo konflikt të mundshëm interesi, duke refuzuar dhurata ose shpërblime në para nga të tretët, përfaqësuesit e tyre ose palë të tjera të interesuara, të cilat bashkëpunojnë me AIDA-n sipas fushës së veprimtarisë së AIDA-s.
3. Punonjësit e AIDA-s zbatojnë kërkesat e parashikuara Ligjin nr. 9637 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar dhe kërkesat e Ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".

Neni 14

1. Paraqitja e punonjësit në punë duhet të jetë e përshtatshme dhe e tillë që të shprehë:
 - a) vëmendje në mënyrën e komunikimit dhe të qëndrimit në ambientet e AIDA-s dhe në ato të të tretëve;
 - b) kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm për pamjen e jashtme;
 - c) plotësimin e kërkesave të domosdoshme të veshjes zyrtare në ambientet e AIDA-s dhe në subjekte.
2. Punonjësit e AIDA-s janë të detyruar të paraqiten në punë me veshje zyrtare. Veshja dhe paraqitja e punonjësit duhet të jetë serioze dhe t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës që kryen. Gjatë gjithë kohës në ambientet e punës, punonjësi duhet të:
 - a) përdorë veshje të tillë që e lejon të duket i rregullt;
 - b) evitojë veshjet e shkurtra dhe të ngjitura pas trupit ose ato shumë të hapura e me

dekolte të madhe;

- c) evitohet veshje të cilat reflektojnë mesazhe vulgariteti, seksualiteti, joshjeje ose të turpshme;
 - ç) evitohet veshjet që ekspozojnë tatuazhet në trup;
 - d) evitohet pantallonat me përbërje materiali elastik, të shkurtra apo tre-çerekëshe, si edhe pantallonat e fizikulturës apo ushtrimeve fizike;
 - dh) bëjë kujdes me këpucët me taka apo platformë. Në ambientet e punës duhet të mos vishen sandale, këpucë me taka, me lartësi të madhe, këpucë ose atlete me platformë apo me gomë të trashë;
 - e) mbajë pamje të kuruar me flokë të rregullt dhe me tualet natyral;
 - ë) mos e teprojë me aksesore apo bizhuteri. Në zyrë bizhuteria duhet të jetë minimaliste.
3. Punonjësit e AIDA-s duhet t'i trajtojnë kolegët e tyre (qofshin këta eprorë apo vartës) me mirësjellje dhe respekt dhe nuk mund kenë tendenca të ngacmimeve fizike apo me fjalë.
 4. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre punonjësit e AIDA-s duhet të reflektojnë një nivel të lartë të kulturës e etikës së komunikimit dhe të jenë shembull e model i komunikimit etik, civil dhe qytetar. Ata duhet që gjithnjë të shmangin edhe ato sjellje, që megjithëse nuk arrijnë në nivelin e ngacmimit apo të abuzimit, mund të krijojnë një atmosferë jomiqësore apo frike.
 5. Do të konsiderohen si ngacmime dhe do të trajtohen si të tilla, të gjitha ato fjalë apo sjellje që ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme në punën e gjithkujt apo që krijojnë një mjedis pune frikësues (kërcënues), armiqësor dhe fyes. Një vend pune i hapur dhe i besueshëm është thelbësor për efektivitetin e punës në AIDA. Do të konsiderohen si ngacmime seksuale dhe do të trajtohen si të tilla të gjitha përpjekjet (avancimet) e padëshiruara seksuale, kërkesat për favore seksuale ose të tjera sjellje (fizike ose me fjalë) me natyrë seksuale, të cilat ndërhyjnë në punën, kushtëzojnë punësimin apo krijojnë një mjedis pune fyes, armiqësor apo frikësues, brenda AIDA-s.
 6. Për çdo rast të ankesave për një demonstrim të sjelljes nga punonjësit, jo në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë kod, do të jetë objekt i shqyrtimit ballafaqimit dhe verifikimit nga Komisioni i Etikës.

Neni 15

Si pasojë e karakterit demokratik dhe profesional që ka AIDA dhe e vlerës që i jep diversitetit, punonjësit e AIDA-s duhet që të sillen dhe të veprojnë me tolerancë, me ndjeshmëri, me respekt dhe me paanësi kundrejt kulturës dhe profesionit të personave të tjerë, që nuk i kanë të njëjta me punonjësit e AIDA-s.

Neni 16

1. Komisioni i Etikës dhe/ose Drejtuesit e drejtorive kanë përgjegjësinë që të jenë të disponueshëm për punonjësit, të cilët duan të ngrenë çështje apo shqetësime në mirëbesim (vetëm për vetëm) dhe t'i trajtojnë me ndjeshmëri, paanshmëri, objektivitet dhe pa diskriminim situata të tilla.
2. Komisioni i Etikës dhe/ose Drejtuesit drejtorive duhet të krijojnë një atmosferë, ku

punonjësit të ndjehen të lirë të përdorin (pa pasur frikë për ndëshkime), rrugët institucionale ekzistuese për zgjidhjen e problemeve apo të konflikteve të çdo lloji, si edhe të shprehin shqetësime lidhur me situatat problematike apo konfliktuale ku ndodhen ose ku mund të ndodhen, jo vetëm lidhur me marrëdhëniet e tyre brenda AIDA-s.

3. Në çdo rast dhe për çdo problem në lidhje me këtë fushë, punonjësit e AIDA-s kanë të drejtë të adresojnë kërkesën e tyre për takim me Drejtorin Ekzekutiv, me synim trajtimin e situatave, sjelljeve, dilemave, shqetësimeve apo problemeve etike.

Neni 17

1. Çdo punonjës i AIDA-s ka të drejtë të mbrohet kundrejt akuzave të pabaza.
2. Dëmtimi i punonjësit të AIDA-s, që vjen si rezultat i akuzave të pabazuara dhe joserioze, dekurajon stafin lidhur me sjelljen dhe me zbatimin e standardeve të larta etike. Si pasojë, AIDA mbron punonjësit, në rastet kur ata bëhen objekt i akuzave të pabaza nga çdokush që mbetet i pakënaqur, si pasojë e kryerjes së rregullt të detyrës prej tyre.
3. Liria dhe përgjegjësia për të ngritur probleme, çështje apo shqetësime është thelbësore për të fuqizuar stafin dhe për të ruajtur integritetin si institucion. Si pasojë, AIDA do të mbrojë stafin nga akuzat e pabazuara, përfshirë edhe ato të ardhura si pasojë e qëndrimeve të mbajtura në rastin e ngritjes së problemeve dhe të shqetësimeve të ndryshme gjatë zbatimit të detyrave. Ankesat për këto raste do të trajtohen seriozisht dhe do të sqarohen menjëherë nga eprori i punonjësit, në bashkëpunimin me Komisionin e Etikës.

Neni 18

1. AIDA respekton konfidencialitetin e të gjithë punonjësve. Informacionet konfidenciale (përfshirë dosjet personale, shënimet mjekësore, informacione lidhur me hetime të ndryshme, si dhe masat disiplinore), nuk do të lejohet që të keqpërdoren, nuk do të zbulohen dhe do të lejohet që të njihen vetëm nga persona të autorizuar. AIDA ruan konfidencialitetin e çdo informacioni, në përputhje me aktet përkatëse ligjore dhe/ose nënligjore të nxjerra prej tij.
2. AIDA nuk do të kërkojë që të ndryshojë sjelljet personale të punonjësve, për aq kohë sa këto sjellje nuk dëmtojnë rezultatet e punës.
3. AIDA respekton ekuilibrin punë-familje si një sfidë për arritjen e objektivave të paracaktuara dhe çmon përpjekjet për ruajtjen e këtyre raporteve. AIDA do të përpiqet që të krijojë një mjedis të brendshëm sa më të mirë që të jetë e mundur, në mënyrë që t'i mbështesë punonjësit, për të arritur një ekuilibër sa më të efektshëm ndërmjet punës, jetës familjare dhe asaj personale.
4. AIDA nuk dëshiron të ndërhyjë në jetën e tyre personale. Sidoqoftë, statusi i tyre si anëtarë të stafit të AIDA-s ka si pasojë disa detyrime lidhur me sjelljen në punë dhe jashtë saj. AIDA i kushton rëndësi të madhe zbatimit, nga ana e punonjësve të saj, të të gjitha akteve ligjore e nënligjore në fuqi, sikurse edhe shmangies së veprimeve që mund të perceptohen si shpërdorim i prestigjit apo privilegjeve që ka AIDA dhe stafi i saj.
5. AIDA, në mënyrë të veçantë, do të jetë, gjithashtu, e vëmendshme, lidhur me sjelljet e pahijshme, të shprehura ose jo publikisht, lidhur me dhunën në familje apo me abuzimin me anëtarët e familjes.

Neni 19

Në lidhje me marrëdhëniet me median dhe deklaratimet publike, punonjësi i AIDA-s duhet të shmangë çfarëdolloj sjelljeje në publik, të kryejë deklaratime në publik apo media, që mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit, që mund të interpretohet apo të lidhet, në ndonjë mënyrë, me pozicionin e tij në AIDA. Statusi i një të punësuarit në AIDA kërkon rezervim dhe takt. Punonjësi i AIDA-s është i detyruar që të zbatojë me rigorozitet procedurat e parashikuara lidhur me këto kontakte.

Neni 20

Punonjësit e AIDA-s duhet ta kryejnë punën e tyre në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore që ruajnë dhe mbrojnë mjedisin. AIDA i kushton vëmendje të veçantë ndikimit që kanë veprimet e saj në ruajtjen e mjedisit, ndjen përgjegjësinë që të ngrejë çështje dhe shqetësime lidhur me kushtet që konsiderohen të dëmshme për shëndetin dhe për sigurinë njerëzore apo për mjedisin, si brenda, ashtu edhe jashtë institucionit.

Neni 21

1. Për të ndjekur çështjet që kanë të bëjnë me etikën, krijohet Komisioni i Etikës, i cili ngrihet me Urdhër të Kryetarit dhe funksionon si organizëm *ad-hoc* i gjykimit profesional.
2. Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë.
3. Komisioni trajton, verifikon, këshillon dhe u jep zgjidhje çështjeve, dilemave, ankesave që kanë të bëjnë me zbatimin e kërkesave të këtij kodi.
4. Komisioni shqyrton rastet e shkeljes së etikës dhe integritetit të çdo personi në AIDA, të cilat lidhen me ushtrimin e veprimtarisë dhe përbëjnë shkelje të KBE-së. Ai propozon masa disiplinore duke vepruar si gjykim në shkallë të parë. Vendimet e tij janë të ankueshëm tek Drejtori Ekzekutiv, i cili shqyrton si shkallë e dytë. Kundër vendimit të Drejtorit Ekzekutiv mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë, Tiranë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Ankimi i vendimit të Drejtorit Ekzekutiv në gjykatë nuk e pengon ekzekutimin e tij.
5. Komisioni i Etikës shqyrton dhe gjykon në bazë të fakteve e provave të administruara në seancën dëgjimore me punonjësin/it e AIDA-s, ndaj të cilit/ve propozohet masa disiplinore. Në rastet kur vërtetohet se punonjësi ka kryer shkelje të etikës përveç rasteve kur ato përbëjnë vepër penale, ai propozon masa, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, ligjin nr. 10 303, datë 15/07/2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, Statutin e AIDA-s, Rregulloren e Brendshme të AIDA-s, si dhe akteve të tjera të brendshme të AIDA-s.

Neni 22

Ndaj punonjësve të AIDA-s, që shkelin parimet dhe dispozitat e këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, do të merren masa, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, ligjin nr. 10 303, datë 15/07/2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë

Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, Statutin e AIDA-s, Rregulloren e Brendshme të AIDA-s, si dhe akteve të tjera të brendshme të AIDA-s.

Neni 23

Ky Kod lexohet e zbatohet në mënyrë integrale, së bashku me të gjitha aktet normative në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Ky kod hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

SOKOL NANO

